



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 01/315 Dt. 18/03/2019

Bazuar në dispozitat e nenit 8, paragrafi 3, nënparagrafi 3.5 dhe nenit 13, paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 48, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, Senati i Universitetit, në takimin e mbajtur më 4.3.2019, miratoi këtë

RREGULLORE PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "KADRI ZEKA" NË GJILAN

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore i përcakton kushtet e përgjithshme për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune të bazuara në Ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit, si dhe kriteret e veçanta për zgjedhjen e personelit akademik të nxjerra nga Senati i Universitetit.

Neni 2

Profesorët e rregullt, profesorët e asociuar dhe profesorët asistentë duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, të hulumtimit dhe të praktikës profesionale apo artistike.

Neni 3

1. Universiteti siguron dhe mbështet barazinë gjinore.
2. Në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i kanë kualifikimet e njëjta, përparësi do t'i jepet kandidates femër.

Neni 4

1. Vendimin për shpallje të konkursit për zgjedhje apo rizgjedhje të personelit akademik e merr Senati i Universitetit, sipas propozimit të njësisë akademike.
2. Konkursi zgjat jo më pak se 15 ditë nga dita e shpalljes.
3. Vendimi për shpallje të konkursit për rizgjedhje duhet të miratohet nga Senati 6 muaj para kalimit të kohës për të cilën janë zgjedhur.
4. Konkursi duhet të përmbajë lëmin shkencor në të cilin zgjedhet kandidati, afatin dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje.

Neni 5

Kandidatët që i kanë kryer studimet baçelor, master, magjistraturë dhe doktoraturë - jashtë vendit, duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Neni 6

1. Për vlerësimin e kandidatëve formohet komisioni recensues. Komisionin recensues e propozon Këshilli i Fakultetit dhe e miraton Senati, jo më vonë se 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.
2. Dekani, në afat prej 8 ditëve, i lajmëron formalisht anëtarët e komisionit recensues për formimin dhe përbërjen e tij.
3. Komisioni recensues përbëhet nga 3 (tre) anëtarë.
 - 3.1. Së paku dy nga anëtarët e komisionit duhet të jenë nga fusha e ngushtë e studimeve për të cilën shpallet konkursi.
 - 3.2. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë intern ose ekstern (nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit).
 - 3.3. Anëtarët e komisionit recensues nuk mund të jenë me thirrje më të ulët se thirrja për të cilën konkurron dhe zgjedhet kandidati.
 - 3.4. Anëtarë të komisionit recensues mund të jenë edhe personat e pensionuar me thirrje shkencore (profesor i rregullt dhe i asociuar), por jo edhe ata të cilët e kanë kaluar moshën 70 vjeçare.

Neni 7

1. Komisioni recensues shkruan referatin vlerësues me propozimin konkret për zgjedhje/moszgjedhje.
 - 1.1. Komisioni mbush formularin e veçantë me pikët për çdo kategori veç e veç dhe pikët në total.
 - 1.2. Referatin vlerësues dhe formularin e veçantë ia dorëzon njësisë akademike, për të gjithë kandidatët e paraqitur.
2. Komisioni recensues mund të vendosë për intervistim të kandidatëve dhe veçanërisht kur dy ose më tepër kandidatë kanë të arritura të ngjashme.

Neni 8

PROCEDIMI I REFERATIT VLERËSUES DHE RAPORTIT TË VEÇANTË DERI TE VENDIMMARRJA PËRFUNDIMTARE

1. Referati vlerësues i komisionit recensues përmban:
 - 1.1. Të dhënat për kandidatin;
 - 1.2. Të dhënat e tjera për përmbushjen e kushteve të përgjithshme (neni 12, 13, 14) dhe raportin e veçantë për kriteret e veçanta (neni 15), sipas kësaj Rregullore.
2. Referati vlerësues shkruhet për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs, me arsyttime të detajuara.
3. Gjatë procesit të vlerësimit kandidatët paraqesin një ligjëratë provuese – vlerësuese. Ligjërata provuese paraqitet vetëm me rastin e pranimit për herë të parë në punë në UKZ, ndërsa për herët e tjera merret parasysh performanca dhe cilësia në mësimdhënie e kandidatit, e cila merret nga Zyra për Zhvillim Akademik.



4. Në cilësinë e vlerësuesit, përveç anëtarëve të komisionit vlerësues, do të asistojë së paku edhe një anëtar nga stafi menaxhues i fakultetit apo Universitetit.
5. Në fund të referatit qëndron propozimi për zgjedhje të kandidatit më të mirë ose për moszgjedhje të asnjë kandidati. Propozimi për zgjedhje i elaboron arsyet për këtë propozim, si dhe konstatimet për secilin kandidat që nuk është propozuar.
6. Pjesë e kësaj Rregulloreje janë edhe formati i referatit vlerësues dhe formulari i veçantë.
7. Komisioni recensues ia dorëzon raportin njësisë akademike, brenda 30 ditëve, pas miratimit të vendimit për formimin e komisioneve vlerësuese.
8. Nëse ndonjë anëtar i komisionit recensues ka mendim të ndryshëm për propozimin për zgjedhjen e kandidatit, ai mund të paraqesë një "Referat vlerësues të veçantë". Ky referat vlerësues duhet të jetë i plotë dhe në përputhje me kërkesat e detajuara këtu.
9. Në raste të tilla, dekani do të paraqesë të dy raportet në Këshill të Fakultetit dhe në Senat të Universitetit. Së pari votohet referati vlerësues i komisionit e pastaj edhe referati vlerësues i anëtarit të komisionit.
10. Senati mund ta rikthejë referatin vlerësues të një anëtari të komisionit vlerësues për mendim shtesë në Këshillin e Fakultetit.
11. Këshilli i Fakultetit dhe Senati i Universitetit mbajnë të drejtën të pranojë njërin, të refuzojë të dy raportet, por nuk mund të miratojë të dy për të njëjtën pozitë.
12. Universiteti, nëpërmjet Zyrës së burimeve njerëzore e publikon referatin vlerësues (por jo edhe raportin e veçantë) të komisionit recensues. Referati vlerësues qëndron i publikuar për pesëmbëdhjetë (15) ditë.
13. Kandidatët kanë të drejtën e ankesës në referatin vlerësues.
 - 13.1. Ankesën ia drejtojnë Këshillit të Fakultetit.
 - 13.2. Këshilli i Fakultetit formon komisionin për shqyrtimin e ankesave.
 - 13.3. Komisioni brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve i bën një raport Këshillit të Fakultetit.
 - 13.4. Komisioni mund të miratojë, të refuzojë apo të hedhë ankesën.
14. Këshilli i Fakultetit voton referatin e komisionit vlerësues, bashkë me raportin e komisionit të ankesave ndaj pretendimeve të kandidatëve, brenda dhjetë (10) ditëve.
15. Këshilli i Fakultetit e miraton apo e refuzon propozimin e komisionit dhe e dërgon në Komision të Studimeve të Universitetit.
16. Brenda tridhjetë (30) ditëve Komisioni i Studimeve i propozon Senatit për vendimmarrje.
17. Senati, me shumicë votash, voton për apo kundër referatit vlerësues për kandidatët veç e veç. Referati vlerësues duhet të shoqërohet me raportin e veçantë dhe me Raportin e Komisionit të Studimeve.
18. Me vendimin e Senatit njoftohen të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs, për vendimet e veta.
19. Pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të vendimit të Senatit dhe njoftimit të kandidatëve, mund të ushtrohet ankesë (shkalla e dytë) ndaj vendimeve të Senatit.

20. Komisioni i ankesave i Universitetit do të shqyrtojë ankesat brenda tridhjetë (30) ditëve dhe i bën një raport Senatit, në të cilin miraton, refuzon apo hedh pretendimet e kandidatëve.
21. Në rast se komisioni i ankesave refuzon apo hedh pretendimet e kandidatëve, çështja mbyllet me njoftimin e Senatit. Nëse komisioni i ankesave miraton pretendimet e kandidatëve Senati edhe një herë voton për raportin e komisionit të ankesave.
22. Vendimi i Senatit është përfundimtar. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të iniciojnë procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 9

I gjithë personeli akademik, pas përfundimit të procedurave të rregullta, do të emërohet nga rektori, sipas vendimit të Senatit të bazuar në propozimin e njësisë akademike.

Neni 10

1. Në stafin akademik të Universitetit do të punësohen apo angazhohen personat në:
 - 1.1. Mësimdhënie akademike;
 - 1.2. Kërkime shkencore;
 - 1.3. Krijimtari artistike.
2. Personeli akademik përbëhet nga:
 - 2.1. Profesorët e rregullt (Prof. Dr.);
 - 2.2. Profesorët e asociuar (Prof. Asoc. Dr.);
 - 2.3. Profesor asistentë (Prof. Ass. Dr.)
 - 2.4. Ligjërues;
 - 2.5. Asistent (Ass.).
 - 2.6. Lektorët dhe korepetitorët

KUSHTET PËR PRANIMIN DHE ZGJEDHJEN E PROFESORIT TË RREGULLT, TË PROFESORIT TË ASOCIUAR DHE TË PROFESORIT ASISTENT

Neni 11

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR I RREGULLT (PROFESOR DOKTOR, PROF. DR. DHE PRANIMI NË PUNË)

1. Për titullin e profesorit të rregullt kandidati duhet të ketë gradën e doktorit të shkencës dhe thirrjen e profesorit të asociuar.
2. Emërimet për titullin *Profesor i Rregullt*, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen për kohë të pacaktuar.
3. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik “Profesor i asociuar”, aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor Doktor”, të paktën 4 (katër) vite pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”.
4. Personeli akademik që aplikon për titullin akademik “Profesor Doktor”, duhet të:
 - 4.1. jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
 - 4.2. ketë udhëhequr dhe përfunduar, të paktën 2 (dy) doktorata. Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë akademike shkencore pranë një njësie akademike me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën 1



(një) doktoratë të përfunduar ose të ketë qenë anëtar i komisionit për mbrojtjen apo vlerësimin e tezës së doktoratës në së paku 5 (pesë) raste.

5. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor Doktor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve, si më poshtë vijon:

- 5.1. Ka botuar, së paku, 9 (nëntë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku 5 (pesë) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të ranguara në platformat digjitale të përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ i MASHT. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë ose korrespondues. Kandidati duhet të jetë autor i parë në të paktën, 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
- 5.2. Ka realizuar si autor i parë, së paku 3 (tri) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në *Proceedings*, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN dhe ato që nuk janë të publikuara në *Proceedings*.
- 5.3. Ka realizuar së paku 2 (dy) monografi shkencore ose 2 (dy) libra universitarë dhe tekste analoge.

6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në nënparagrafin 5.1, të paragrafit 5 të këtij neni, sipas ekuivalentimit që vijon:

- 6.1. Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Profesor i asociuar” në gjuhën shqipe apo në njërën prej gjuhëve botërore, duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore dhe të jetë pranuar nga njëسيا bazë, që mbulon fushën e kërkimit.
- 6.2. Monografia e botuar në gjuhën shqipe duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore.

7. Libri universitar duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si tekst universitar nga 2 (dy) “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore dhe duhet të jetë e botuar me lejen apo në një institucion të arsimit të lartë, i akredituar sipas ligjeve në fuqi, i cili ka së pakut një program studimor në fushën shkencore në të cilën është shkruar teksti universitar.

8. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e ranguar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70 %.

8.1. Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet në mënyrë reciproke me:

- 8.1.1. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore në gjuhën shqipe;
- 8.1.2. 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

9. Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet në mënyrë reciproke me:

- 9.1. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore në gjuhën shqipe;
- 9.2. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

10. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”, në:

- 10.1. komitete shkencore apo redaktuese;
- 10.2. veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
- 10.3. projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
- 10.4. përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

- 10.5. projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - 10.6. vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - 10.7. si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - 10.8. projektet e transferimit teknologjik të patentave.
11. Referati vlerësues për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit në veprimtaritë e parashikuara në paragrafët 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 hartohet në mënyrë të detajuar nga Komisioni vlerësues.
 12. Për titullin “Profesor Doktor” kandidati duhet të tubojë më së pakut 91 pikë, nga kriteret obligative, sipas kësaj rregulloreje. Pikët e punimeve shkencore mbledhen në kontinuitet prej mbas fitimit të gradës “Doktor Shkence”.

Neni 12

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR I ASOCIUAR (PROF. ASOC.) DHE PRANIMI NË PUNË

1. Për titullin e profesorit të asociuar kandidati duhet të ketë gradën e doktorit të shkencës dhe thirrjen e profesorit asistent.
2. Emërimi për titullin “Profesor i asociuar”, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.
3. Aplikimi për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar”, bëhet të paktën, 4 (katër) vite pas fitimit të titullit akademik “Profesor asistent”.
4. Personeli akademik që aplikon për titullin akademik “Profesor i asociuar”, duhet të:
 - 4.1. ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 4 (katër) vite akademike;
 - 4.2. jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 4 (katër) vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
5. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor i asociuar”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:
 - 5.1. Ka botuar, së paku 6 (gjashtë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara.
 - 5.2. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të ranguara në platformat digjitale të përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ i MASHT. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë, i dytë ose autor korrespondent.
 - 5.3. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 3 (tre) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
 - 5.4. Ka realizuar si autor i parë, së paku 2 (dy) referime, nga të cilat, së paku 1 (një) është mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN, dhe ato që nuk janë të publikuara në *Proceedings*.
 - 5.5. Ka publikuar së pakut 1 (një) monografi shkencore ose 1 (një) libër universitar dhe tekste analoge.
6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në nënparagrafin 5.1, të paragrafit 5 të këtij neni, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - 7.1. Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Profesor asistent” në gjuhën shqipe apo në njërën prej gjuhëve botërore, duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga 2 (dy) vlerësues

- të pavarur të fushës kërkimore-shkencore dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit.
- 7.2. Monografia e botuar në gjuhën shqipe duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë të asociuar” ose “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore.
- 7.3. Libri universitar duhet të jetë i vlerësuar në përmbajtje si tekst universitar nga 2 (dy) “Profesorë të asociuar” ose “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore dhe duhet të jetë i botuar me lejen apo në një institucion të arsimit të lartë, i akredituar sipas ligjeve në fuqi, i cili ka së pakut një program studimor në fushën shkencore në të cilën është shkruar monografia.
- 7.4. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e ranguar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D.
- 7.5. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70 %. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore;
- 7.6. Monografia e botuar brenda vendit ekuivalenohet në mënyrë reciproke me:
- 7.6.1. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore në gjuhën shqipe;
- 7.6.2. 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
- 7.7. Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalenohet në mënyrë reciproke me:
- 7.7.1. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore në gjuhën shqipe;
- 7.7.2. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
8. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”, në:
- 8.1. komitete shkencore apo redaktuese;
- 8.2. veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
- 8.3. projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
- 8.4. përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- 8.5. projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
- 8.6. vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare
- 8.7. si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
- 8.8. projektet e transferimit teknologjik të patentave.
9. Referati vlerësues për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit në veprimtaritë e parashikuara në paragrafët 4, 5, 6, 7, 8 hartohet në mënyrë të detajuar nga Komisioni vlerësues.
10. Për titullin “Profesor i asociuar” kandidati duhet të tubojë më së pakut 71 pikë nga kriteret obligative sipas kësaj Rregulloreje. Pikët e punimeve shkencore mbledhen në kontinuitet prej mbas fitimit të gradës Doktor Shkence.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR ASISTENT (PROF. ASS.) DHE PRANIMI NË PUNË

1. Për ta fituar titullin “Profesor asistent”, kandidati duhet:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 - 1.2. Të jetë ose të ketë përvojë universitare për një periudhë jo më të shkurtër se 3 (tri) vite akademike.
2. Emërimi për titullin “Profesor asistent”, si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.
3. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor asistent”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve, si më poshtë vijon:
 - 3.1. Ka botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore në gjuhën shqipe ose në revista ndërkombëtare të indeksuara.
 - 3.2. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jetë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të ranguar në platformat digjitale të përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ i MASHT-it.
 - 3.3. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën 1 (një) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
4. Ka realizuar si autor i parë, së paku, 2 (dy) referime në veprimtari shkencore (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN, dhe ato që nuk janë të publikuara në *Proceedings*.
5. Kandidatëve për profesor asistentë u njihet teza e doktoratës si monografi.
6. Kur kandidati paraqet monografi të dytë, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në nënparagrafin 3.1 dhe 3.2, të paragrafit 3 të këtij neni, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - 6.1. Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës “Doktor Shkence” në gjuhën shqipe apo në njërin prej gjuhëve botërore, duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit.
 - 6.2. Monografia e botuar në gjuhën shqipe duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë të asociuar” ose “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore. Libri universitar duhet të jetë i vlerësuar në përmbajtje si tekst universitar nga 2 (dy) “Profesorë të asociuar” ose “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore dhe duhet të jetë i botuar me lejen apo në një institucion të arsimit të lartë, i akredituar sipas ligjeve në fuqi, i cili ka së paku një program studimor në fushën shkencore në të cilën është shkruar monografia.
 - 6.3. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e ranguar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%.
 - 6.4. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore;
7. Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet në mënyrë reciproke me:



- 7.1.2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore në gjuhën shqipe;
 7.2.1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
8. Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalenohet me:
 8.1.4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore në gjuhën shqipe;
 8.2.2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
9. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit Doktor Shkence, në:
 9.1. komitete shkencore apo redaktuese;
 9.2. veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 9.3. projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
 9.4. përfitim të financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 9.5. projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 9.6. vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 9.7. si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 9.8. projektet e transferimit teknologjik të patentave.
10. Referati vlerësuesi për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit në veprimtaritë e parashikuara në paragrafët 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 hartohet në mënyrë të detajuar nga Komisioni vlerësues.
11. Për titullin “Profesor asistent” kandidati duhet të tubojë më së pakut 51 pikë nga kriteret obligative, sipas kësaj rregulloreje.

KRITERET E VEÇANTA PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

Neni 14

1. Llogaritja e pikëve për kandidatët bëhet në këtë ndarje:

<i>Shkollimi + fusha e veprimtarisë</i>	<i>Pikët</i>
1. Bachelor	6-10
2. Master	6-10
3. PhD	6-10
4. Performanca e kandidatit	0-20
5. Prezantimi provues	0-10
6. Gjuhët e huaja	0-10
7. Veprimtari të tjera shkencore dhe angazhime akademike	Shih pikët në tabelën tjetër (jobligative)
8. Punimet	Shih pikët në tabelën tjetër

2. Pikët nga nota mesatare e studimeve llogariten sipas vlerës së notës (p.sh. 8.2 llogaritet 8.2 pikë).
- 2.1. Nëse nuk ka notë mesatare në PhD, atëherë zbatohet nota mesatare e dy niveleve të studimeve paraprake.
- 2.2. Në rast se kandidati i ka të kryer studimet themelore 4-vjeçare dhe ka vazhduar në studimet e doktoratës, atëherë vlerësimi i poenave të masterit llogaritet me sa vijon:

- 2.2.1. Nëse ekziston nota mesatare në PhD, mblidhet me notën mesatare të studimeve themelore dhe pjesëtohet për 2.
- 2.2.2. Nëse nuk ka notë mesatare në PhD, atëherë zbatohet nota mesatare e studimeve themelore.

3. Pikët nga prezantimi provues

Prezantimi provues	0-10
--------------------	------

3.1. Prezantimit provues i nënshtrohen të gjithë kandidatët për titullin “Profesor Asistent” dhe kandidatët për të gjithë titujt akademikë, të cilët konkurrojnë nga jashtë UKZ-së. Staf i akademik i UKZ-së që konkurron për titujt “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor Doktor” vlerësohet sipas performancës.

3.2. Vlerësimi i prezantimit provues bëhet nga anëtarët e Komisionit recensues dhe së paku nga një përfaqësues i fakultetit apo Universitetit. Kandidati informohet më herët për prezantimin dhe ai është i lirë të zgjedhë vetë temën që do të prezantojë.

4. Pikët nga njohja e gjuhëve të huaja

Gjuhë e huaj	Gjuhë angleze, ose një gjuhë tjetër botërore (gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja, spanjishtja, rusishtja)	6
	Gjuhë rajonale (sllave, turke, greke etj.)	3
	Gjuhë të tjera	1

5. Nëse komisioni nuk ka njohuri të mjaftueshme për vlerësim, atëherë kërkohen dokumente shtesë kredibile që dëshmojnë njohuritë nga gjuhët e huaja apo caktohet personi kompetent për vlerësim.

15.4. Pikët minimale nga publikimet shkencore

<i>Lloji i publikimit</i>	
Punim në revista ndërkombëtare, të ranguar sipas Vendimit të MASHT-it	7
Punim në gjuhë të huaj në revista vendore e rajonale (Kosovë, Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Serbia, BeH)	3
Punim në revista në gjuhën shqipe	3
Libër universitar	8
Monografi shkencore	13
Përkthime të monografive shkencore dhe të librave universitarë, të pranuar nga njësi akademike si tekste bazike për studentët	6
Libra të tjerë	3
Mentorime të doktorantëve	5
Anëtar komisioni për vlerësimin/mbrojtjen e doktoratave	2
Mentorime të masterëve	3
Referime shkencore ndërkombëtare (simpoziume, konferenca, kongrese), të publikuara në <i>Proceedings</i>	3

Referime shkencore ndërkombëtare (simpoziume, konferenca, kongrese)	3
Referime shkencore vendore (simpoziume, konferenca, kongrese), të publikuara ose jo në <i>Proceedings</i>	2

6. Pikët në këtë tabelë janë të llogaritura për një punim. Në rast se kandidati ka më tepër punime, shumëzohet me numrin për një punim dhe i llogariten të gjitha.

7. Përvoja e kandidatit në aktivitete të tjera shkencore dhe akademike

<i>Aktivitete dhe përvoja</i>	
Kryesues apo anëtar i këshillit shkencor të një konference shkencore organizuar nga UKZ	6
Kryesues apo anëtar i këshillit shkencor (e të ngjashme) të një konference shkencore vendore a ndërkombëtare; kryeredaktor apo anëtar i redaksisë së një reviste shkencore vendore a ndërkombëtare	5
Koordinator në një projekt të Komisionit Evropian	10
Menaxher i një projekti të Komisionit Evropian	5
Aplikim në projekteve të Komisionit Evropian	4
Përfitues i një projekti hulumtues e financiar, i cili sjell përfitime financiare për institucionin mbi 10.000 Euro	5

Neni 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E TITULLIT ASISTENT DHE PRANIMI NË PUNË

- Për titullin e asistentit kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - Të ketë të përfunduar me sukses *studimet master* në drejtimin përkatës;
 - Të jetë jo më i vjetër se deri në datën kur i mbushë 30 vjet për emërimin e parë; për Fakultetin e Mjekësisë deri në datën kur i mbushë 35 vjet.
 - Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në Universitet me rastin e rizgjedhjes;
- Të ketë notën mesatare, në secilin nivel, jo më pak se 8.
- Të gjitha emërimet, si dhe kohëzgjatja e punësimit janë për 3 vite.
- Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet baçelor dhe master.
- Përrjashtimisht asistenti që është rizgjedhur dhe është doktorant (PhDcand.), në mungesë të profesorit për lëndën mund të autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet baçelor me autorizimin e këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimitdhënësi nga departamenti.

Neni 16

1. Kriteret e veçanta- Asistent

<i>Niveli I studimeve</i>	<i>Pikët</i>
Baçelor	20- 30
Master	20-30
Performanca ne rastin e rizgjedhjes se asistentit	0-30

Prezantimi vlerësues	0-20
Gjuhët e huaja	0-10

2. Pikët e llogaritura sipas notave në nivelet e studimeve

Notat	Bachelor	Master	Pikët (totali)
Nota 8 deri ne 8.5	20	20	40
Nota 8.51 deri ne 9	23	23	46
Nota 9.01 deri ne 9.5	26	26	52
Nota 9.51 deri ne 10	30	30	60

3. Prezantimi provues

Prezantimi provues	0-30
--------------------	------

Vlerësimi i prezantimit provues bëhet nga anëtarët e Komisionit recensues dhe së paku nga një përfaqësues i fakultetit apo Universitetit. Asistentët në rizgjedhje vlerësohen me performancë.

4. Njohja e gjuhëve të huaja

		20 pikë
Gjuhë e huaj	Gjuhë angleze apo një gjuhë tjetër botërore	6
	Gjuhë rajonale (sllave, turke, greke etj.)	3
	Gjuhë të tjera	1

Neni 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E TITULLIT LEKTOR DHE KOREPETITOR

1. Për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;
 - 1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur.
 - 1.3. Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.
2. Lektorët në fakultetet e tjera, pos në fakultetin amë, i kanë të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave.
3. Për titullin e korepetitorit, kandidati duhet ti plotësojë këto kushte:
 - 3.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master, drejtimi i pianos ose ndonjë instrumenti tjetër;
 - 3.2. Të ketë notë mesatare jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve;
1. Të gjitha emërimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit janë për 3 vite.


Neni 18
DISPOZITAT KALIMTARE

1. Neni 11, paragrafi 4, nënparagrafi b vlen nga dita kur UKZ i themelon studimet e doktoratës.
2. Kjo rregullore aplikohet për fitimin e thirrjes së parë akademike (profesor asistent, asistent) dhe për stafin aktual akademik pasi ta marrin thirrjen akademike vijuese (të cilët zgjedhen/rizgjedhen sipas Rregullores për zgjedhjen e personelit akademik në Universitetin “Kadri Zeka” Gjilan, Nr.01/315, dt.18.03.2018, e miratuar në mbledhjen e Senatit më datë 05.03.2019. .

Gjilan, më 5 mars 2019



REKTORI


Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi